

**VENDIM**  
**Nr. 348, datë 26.5.2022**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE  
DHE TEKNIKAVE TË ÇAKTIVIZIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT DHE PJSËVE  
KRYESORE TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 18/1, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e standardeve dhe teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**RREGULLORE**  
**PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE DHE TEKNIKAVE TË ÇAKTIVIZIMIT TË**  
**ARMËVE TË ZJARRIT DHE PJSËVE KRYESORE TË TYRE**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i standardeve dhe i teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë, që do të mundësonte riaktivizimin e tyre.

**Neni 2**  
**Objekti**

Rregullorja “Për përcaktimin e standardeve dhe teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre” përcakton:

1. Standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre.
2. Kategoritë e armëve të zjarrit dhe e pjesëve kryesore, tek të cilat aplikohen standardet dhe teknikat e përcaktuara në këtë Rregullore.
3. Personat fizikë dhe juridikë të autorizuar për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe të pjesëve kryesore të tyre.
4. Autoritetin dhe procedurat e verifikimit e certifikimit të armëve të zjarrit dhe të pjesëve kryesore të tyre, të çaktivizuara.
5. Standardet e markimit dhe të administrimit të dokumentacionit të armëve të zjarrit, pjesëve dhe mekanizmave kryesorë të tyre, të çaktivizuara.

6. Transfertat ndërkombëtare dhe kontrolli i armëve të zjarrit, pjesëve dhe mekanizmave kryesore të tyre, të çaktivizuara.

### Neni 3 **Subjektet**

Subjekte të kësaj Rregulloreje janë:

1. Personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, janë pajisur me armë zjarri dhe të licencuar për veprimtari të lejuara me armët, përfshi koleksionistët e armëve të zjarrit dhe muzetë.
2. Personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, janë pajisur me licencë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.
3. Policia e Shtetit.

### Neni 5 **Fusha e zbatimit**

1. Kjo Rregullore do të zbatohet për armët e zjarrit në pronësi të personave fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar, janë pajisur me armë zjarri dhe të licencuar për veprimtari të lejuara me armët.
2. Kjo Rregullore do të zbatohet për personat fizikë dhe juridikë të autorizuar për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre.
3. Kjo Rregullore do të zbatohet për autoritetin e ngarkuar për verifikimin dhe certifikimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, të çaktivizuara.
4. Kjo Rregullore nuk do të zbatohet për armët e zjarrit të çaktivizuara para datës së zbatimit të saj, përveç nëse ato armë zjarri transferohen në një shtet tjetër ose vendosen në treg, si dhe për armët e zjarrit të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore (armë zjarri antike).

## KREU II STANDARDET DHE TEKNIKAT E ÇAKTIVIZIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT DHE PJESËVE KRYESORE TË TYRE

### Neni 6 **Kategoritë e armëve**

Standardet dhe teknikat e çaktivizimit, sipas kësaj Rregulloreje zbatohen për armët e kategorive “A”, “B” dhe “C”, si më poshtë:

1. Armë zjarri automatike (A2), (A3), (A6), (A7).
2. Armë zjarri të gjata që shprehin më shumë se 11 fishekë pa rimbushje, nëse:
  - a) krehri me kapacitet mbi 10 fishekë është pjesë e kësaj arme (A16);
  - b) krehri i çmontueshëm me kapacitet mbi 10 fishekë futet në këtë armë (A17).
3. Armë zjarri të shkurtra me përsëritje (B1).
4. Armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje qendrore (B2).
5. Armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme nën 28 cm (B3).
6. Armë zjarri të gjata gjysmautamatike me krehër dhe fole, që mund të mbajnë së bashku më shumë se 3 fishekë, në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më shumë se tre, por më pak se dymbëdhjetë fishekë, në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore (B4).
7. Armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmautamatike me tytë të pavjaskuar, me gjatësi deri në 60 cm (B7).

8. Armë zjarri gjysmautematike për përdorim civil, të cilat u ngjajnë armëve me mekanizma automatikë (B9).
9. Armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmautematike me tytë të pavjaskuar (C1).
10. Armë zjarri të gjata me tytë të vjaskuar (C2).
11. Armë zjarri e gjatë gjysmautematike, që nuk përfshihet në kategorinë “A” ose “B” (C3).
12. Armë zjarri të shkurtra me një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme, jo më pak se 28 cm (C4).
13. Armë zjarri të gjata me një qitje me tytë të pavjaskuar (C7).
14. Pjesët kryesore të armëve të zjarrit.

#### Neni 7

### Subjektet e licencuara

1. Çaktivizimi i armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre kryhet nga njësi publike ose private, ose nga individë të licencuar nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.
2. Subjektet e licencuara për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre duhet të plotësojnë kushtet dhe rregullat e përcaktuara sipas nenit 19, të ligjit 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar dhe rregullores “Për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve”, të miratuar me vendimin nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.
3. Subjektet e licencuara për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre duhet të kenë ambiente të sigurta për ruajtje të përshtatshme të armëve, deri në momentin e çaktivizimit.
4. Subjektet e licencuara për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre duhet të kenë pajisjet dhe mjetet e duhura për kryerjen e operacioneve specifike të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, të miratuara në këtë Rregullore.
5. Subjektet e licencuara për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre duhet të jenë të kompletuara me personel të kualifikuar, të cilët duhet të njohin kategoritë e ndryshme të armëve të zjarrit dhe proceset ekzakte, që do të zbatohen te komponentët esenciale dhe pjesët kryesore, në rastet kur është e mundur, me qëllim çaktivizimin e përhershëm të armëve të zjarrit.

#### Neni 8

### Standardet dhe teknikat e çaktivizimit

1. Standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe të pjesëve kryesore të tyre, për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve, të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë, që do të mundësonte riaktivizimin e tyre, janë në përputhje me aneksin I, bashkëlidhur.
2. Procesit të çaktivizimit u nënshtrohen armët në pronësi të shtetasve, personave fizikë ose juridikë, me kërkesën e tyre për t’i mbajtur në pronësi si relike.
3. Kërkesa për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre paraqitet pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.
4. Shpenzimet për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre mbulohen nga kërkuesi.
5. Masa, kriteret dhe procedura për tarifat financiare përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

#### Neni 9

### Kontrolli dhe certifikimi i çaktivizimit të armëve të zjarrit

1. Për kontrollin e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, për të garantuar që modifikimet e kryera në armët e zjarrit i bëjnë të gjitha pjesët kryesore të tyre përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar. Ky komision lëshon certifikatat e çaktivizimit për armët e zjarrit, të cilat janë çaktivizuar dhe markuar.

2. Kur subjekti verifikues është, gjithashtu, i autorizuar të çaktivizojë armët e zjarrit, atëherë sigurohet një ndarje e qartë e detyrave dhe e personave që i kryejnë ato brenda subjektit.

3. Kur çaktivizimi i armës së zjarrit është kryer në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në aneksin e I, Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta i lëshon pronarit të armës së zjarrit një certifikatë çaktivizimi, në përputhje me formatin e përcaktuar në aneksin III.

4. Autoriteti i licencimit dhe Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta mund të kryejnë inspektime monitoruese, duke përfshirë këtu edhe kontrollime të palajmëruara, që të sigurojnë se të gjitha standardet janë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje. Mospajtimi i specifikimeve teknike me kërkesat ligjore për çaktivizimin ose ruajtjen e sigurt të armëve, në raste kur puna akoma nuk ka filluar, apo është e papërfunduar, përbën shkak për shfuqizimin e licencës dhe në disa raste, procedimin penal.

#### Neni 10

### **Markimi i armëve të zjarrit të çaktivizuara**

1. Armët e zjarrit të çaktivizuara markohen në përputhje me formatin standard të përcaktuar në aneksin II, për të treguar që ato janë çaktivizuar, në përputhje me standardet dhe teknikat e përcaktuara në aneksin I.

2. Markimi vendoset nga Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta për të gjithë përbërësit e modifikuar për çaktivizimin e armës së zjarrit dhe duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) është qartësisht i dukshëm dhe i palëvizshëm;
- b) ka informacion për shtetin ku është kryer çaktivizimi dhe entitetin verifikues që ka certifikuar çaktivizimin;
- c) ruhet numri serial origjinal i armës së zjarrit.

#### Neni 11

### **E drejta e mbajtjes së armëve të zjarrit të çaktivizuara**

1. Armët e zjarrit të çaktivizuara, në përputhje me standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, të përcaktuara në këtë Rregullore, lejohen të mbahen nga pronarët e tyre, përfshi këtu koleksionistët dhe muzetë, pa nevojën e autorizimit/lejes ose një dokumenti të ngjashëm.

2. Pronari i armës së zjarri të çaktivizuar duhet të mbajë certifikatën e çaktivizimit në çdo kohë.

3. Nëse arma e zjarrit e çaktivizuar vendoset në treg, ajo shoqërohet me certifikatën e çaktivizimit.

4. Armët e zjarrit të çaktivizuara, jo në përputhje me standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre të përcaktuara në këtë Rregullore, sekuestrohen.

5. Prezantimi i rremë i armës së zjarrit të çaktivizuar, falsifikimi i certifikatës së çaktivizimit, tentimi për riaktivizim apo riaktivizimi i armës së çaktivizuar përbëjnë shkelje dhe ndëshkohen penalisht.

#### Neni 12

## **Transferimi ndërkombëtar i armëve të zjarrit të çaktivizuara**

1. Armët e zjarrit të çaktivizuara mund të transferohen në një shtet tjetër vetëm, atëherë kur ato të kenë markimin unik dhe të shoqërohen nga një certifikatë çaktivizimi, në përputhje me këtë Rregullore, sipas autorizimit/licencës përkatëse nga organi përgjegjës.
2. Republika e Shqipërisë do të njohë certifikatat e çaktivizimit të lëshuara nga çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian, nëse certifikata përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.
3. Kontrolli fizik dhe verifikimi i certifikatës së çaktivizimit në pikat e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë kryhet nga shërbimi doganor dhe Policia e Shtetit.
4. Në rastet kur në pikat e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë konstatohet se arma/armët dhe pjesët kryesore të tyre nuk janë pajisur me certifikatën e çaktivizimit, armët sekuestrohen.

### **Neni 13**

#### **Evidentimi i armëve të zjarrit të çaktivizuara**

1. Policia e Shtetit mban evidencë për certifikatat e lëshuara për armët e zjarrit të çaktivizuara. Evidenca mbahet për një periudhë prej të paktën 20 vjetësh nga data e çaktivizimit të armës së zjarrit.
2. Evidenca e armëve e zjarrit të çaktivizuara është element i regjistrit kombëtar elektronik të armëve të zjarrit, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë.
3. Evidenca e armëve të zjarrit të çaktivizuara duhet të përmbajë të dhëna për pronarin e armës në momentin e çaktivizimit, të dhëna për armën e çaktivizuar dhe të dhëna për certifikatën e çaktivizimit.
4. Evidenca e armëve e zjarrit të çaktivizuara është në përputhje me formatin e përcaktuar në aneksin e IV.

### **KREU III**

#### **DISPOZITAT E FUNDIT**

### **Neni 14**

#### **Dispozitat e fundit**

Kjo Rregullore është e detyrueshme të zbatohet nga:

1. Personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, janë pajisur me armë zjarri dhe të licencuar për veprimtari të lejuara me armët, përfshi koleksionistët e armëve të zjarrit dhe muzetë.
2. Personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, ‘Për armët’”, janë pajisur me licencë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të kërkojë e të mbikëqyrë zbatimin e rregullave, procedurave, standardeve, të përcaktuara në këtë Rregullore.

### **ANEKSI I**

#### **SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR ÇAKTIVIZIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT**

Operacionet e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre do të kryhen në mënyrë që të garantojnë, që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve, të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë, që do të mundësonte riaktivizimin e tyre.

Operacionet e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre përcaktohen në bazë të tri tabelave:

- Tabela I rendit llojet e ndryshme të armëve të zjarrit;
- Tabela II përcakton parimet e përgjithshme, që duhen ndjekur për çaktivizimin e armëve të zjarrit;
- Tabela III përshkruan operacionet specifike, që duhen kryer për çaktivizimin e armëve të zjarrit.

Specifikimet teknike për çaktivizimin e armëve të zjarrit duhet të parandalojnë riaktivizimin e armëve të zjarrit me përdorimin e mjeteve të zakonshme.

Specifikimet teknike për çaktivizimin e armëve të zjarrit duhet të fokusohen në çaktivizimin e pjesëve kryesore të armës, përfshi edhe ato që janë në rezervë për çdo armë.

Specifikimet teknike për çaktivizim e armëve të zjarrit duhet të rishqyrtohen periodikisht, që të përfshijnë zhvillimet teknologjike të armëve dhe operacioneve të çaktivizimit.

Miratimi i standardeve të përbashkëta për të gjitha vendet anëtare të BE, do ta ulte rrezikun për të gjithë. Zhvillimi i specifikimeve teknike për çaktivizim duhet të jenë të bazuara te vlerësimi i rrezikut dhe nivelit të kërcënimit, bashkë me vlerësimin e nivelit të zhvillimit të teknikave dhe kapaciteteve të inxhinierisë, të cilat duhet të tejkalohen, që të sigurohet çaktivizimi i përhershëm.

**Tabela I. Lista e llojeve të armëve të zjarrit**

| Nr. | LLOJET E ARMËVE TË ZJARRIT                                                                                                                          |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Armë zjarri të shkurtra (pistoletat me një shkrepje të vetme, gjysmautematike)                                                                      |
| 2   | Armë zjarri të shkurtra (revolverët, duke përfshirë ato me mulli/cilindër)                                                                          |
| 3   | Armë zjarri të gjata me një shkrepje të vetme                                                                                                       |
| 4   | Armë zjarri të gjata e të shkurtra me veprim me ndërprerje (me ose pa vjaska, me mekanizëm të mbylljes së fishekut me ulje poshtë ose me rrotullim) |
| 5   | Armë zjarri të gjata me përsëritje (me ose pa vjaska)                                                                                               |
| 6   | Armë zjarri të gjata gjysmautematike (me ose pa vjaska)                                                                                             |
| 7   | Armë zjarri automatike (automatik të ndryshëm, mitraloza, pistoletat automatike)                                                                    |
| 8   | Armë zjarri që mbushen nga gryka                                                                                                                    |

**Tabela II. Parimet e përgjithshme për çaktivizimin e armëve të zjarrit**

| Nr. | PARIME TË PËRGJITHSHME                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Njësia çaktivizuese duhet të parandalojë çmontimin e përbërësve thelbësorë të armëve të zjarrit, duke salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                       |
| 2   | Procesi i çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre do të kryhet pas kontrollit të ushtruar nga Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta.                                                                                                                               |
| 3   | Njësia çaktivizuese duhet të sigurojë që materialet, që do të përdoren për ngjitje/fiksim të pjesëve dhe mekanizmave të armëve të zjarrit që çaktivizohen (perçinat/kunjat/bulonat), duhet të jenë të paktën 40 HRC, ndërsa materiali që përdoret për saldim duhet të sigurojë një ngjitje të qëndrueshme. |

**Tabela III. Operacionet specifike për çaktivizimin e armëve të zjarrit**

| 1. Armë zjarri të shkurtra (pistoletat me një shkrepje të vetme, gjysmautematike) |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.1                                                                               | Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë, duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat e me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut).                                                                                                                                                                                                                  |
| 1.2                                                                               | Tyta: Për të gjitha pistoletat, përveç atyre me një qitje të vetme, duhet të shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut, përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide. |
| 1.3                                                                               | Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 1.4                                                                               | Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 1.2 mund të përdoret për këtë qëllim.                                                                                                                                                                                                                            |
| 1.5                                                                               | Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 1.1–1.4 dhe 1.19. Tytat duhet të parandalohen që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke                                                                                                                                                                                                                                                                          |

|                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|--------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                      | përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 1.6                                                                                  | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 1.7                                                                                  | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet me makinë metalprerëse faqja e përparme, në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.                                                                                                                                                                    |
| 1.8                                                                                  | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 1.9                                                                                  | Rrëshqitësi/djepi: Pritet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë, në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë sipërfaqen.                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 1.10                                                                                 | Rrëshqitësi/djepi: Hiqet susta e gjilpërës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| 1.11                                                                                 | Rrëshqitësi/djepi: Hiqen kanalet e mbylljes me rrëshqitje.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 1.12                                                                                 | Rrëshqitësi/djepi: Kur është e zbatueshme pritët me makinë metalprerëse pjesa e brendshme fundore, në një kënd 45 deri 75 gradë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 1.13                                                                                 | Rrëshqitësi/djepi: Kur bllokuesi është i heqshëm nga trupi i rrëshqitësit/djepit, bllokuesi duhet të fiksohet përgjithmonë me trupin e rrëshqitësit/djepit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| 1.14                                                                                 | Trupi dhe doreza: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 1.15                                                                                 | Trupi dhe doreza: Pritet me makinë metalprerëse, të paktën 2/3 e pjesës fundore të shinave rrëshqitëse në të dy anët.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 1.16                                                                                 | Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/salidohe këmbëza e shkrepjes me trupin, nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjithës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                      |
| 1.17                                                                                 | Mekanizmi i shkrepjes: Saldohe në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjithës rezistent ndaj temperaturave të larta kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 1.18                                                                                 | Sistemi automatik: Shkatërrohet pistoni i gazit, tubi i gazit dhe rruga e gazit duke i prerë ose salduar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 1.19                                                                                 | Sistemi automatik: Nëse nuk ka piston gazi, hiqet tubi i gazit. Nëse tyta përdoret si piston gazi, ajo saldohe me trupin e armës. Në të gjitha rastet kur është e pranishme, mbyllet rruga e daljes së gazit nga tyta me saldim.                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 1.20                                                                                 | Magazina/krehri: Saldohe magazina/krehri me pika saldimi me dorezën e armës ose, në varësi të llojit të armës dhe materialit, përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, për të parandaluar heqjen e magazinës nga arma.                                                                                                                                                                                                                      |
| 1.21                                                                                 | Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri mungon, vendosen pika saldimi ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë ose fiksohet një kyç, për të parandaluar futjen e magazinës në armë.                                                                                                                                                                                                                                                        |
| 1.22                                                                                 | Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje, ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.                                                                                                                                                                                                         |
| 1.23                                                                                 | Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve. |
| <b>2. Armë zjarri të shkurtra (revolverët, duke përfshirë ato me mulli cilindër)</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 2.1                                                                                  | Tyta: Kryhet një prerje gjatësore (gjerësia: 1/2 >kalibër; gjatësia: minimumi i gjatësisë së tytës nga pjesa fundore).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| 2.2                                                                                  | Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali (gjatësia: minimumi gjysma e gjatësisë së folesë së fishekut) në tytë dhe të ngjitet në mënyrë solide.                 |
| 2.3                                                                                  | Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 2.2 mund të përdoret për këtë qëllim.                                                                                                                                                                                                                  |
| 2.4                                                                                  | Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 2.1–2.3. Tytat duhet të parandalohen që të mos vendosen në një armë zjarri, duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                                                    |
| 2.5                                                                                  | Cilindri/mulliri: Hiqen me makinë metalprerëse të gjitha muret e brendshme nga cilindri për një minimum prej 2/3 të gjatësisë së tij. Hiqen sa më shumë të jetë e mundur e mureve të brendshme të cilindrit/mullirit, sa më afër diametrit, pa prishur muret e jashtme.                                                                                                                                                                                                             |
| 2.6                                                                                  | Cilindri/mulliri: Kur është e mundur saldohe cilindri me kornizën ose përdoren masat e duhura, si vendosja e kunjit, me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë për të parandaluar heqjen.                                                                                                                                                                                                                                                                                          |

|                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 2.7                                                                                                                                                           | Cilindri/mulliri: Për cilindrato rezervë, që nuk janë montuar në armë zjarri, zbatohet operacioni 2.5. Përveç kësaj, cilindri duhet të parandalohet që të vendoset përgjithmonë në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                       |
| 2.8                                                                                                                                                           | Trupi dhe doreza: Zgjerohet vrima e gjilpërës tre herë në raport me origjinalin.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 2.9                                                                                                                                                           | Trupi dhe doreza: Hiqet ose shkurtrohet gjilpëra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 2.10                                                                                                                                                          | Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit, midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjithës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                      |
| 2.11                                                                                                                                                          | Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 2.12                                                                                                                                                          | Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.                                                                                                                                                                                                          |
| 2.13                                                                                                                                                          | Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme, ku është e mundur dhe pikat e lidhjes, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve.         |
| <b>3. Armë zjarri të gjata me një shkrepje të vetme (me veprim pa ndërprerje)</b>                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 3.1                                                                                                                                                           | Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë, duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat e me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut).                                                                                                                                                                                                        |
| 3.2                                                                                                                                                           | Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut, përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.                                                              |
| 3.3                                                                                                                                                           | Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 3.4                                                                                                                                                           | Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 3.2 mund të përdoret për këtë qëllim.                                                                                                                                                                                                                  |
| 3.5                                                                                                                                                           | Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 3.1–3.4. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme, që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                            |
| 3.6                                                                                                                                                           | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtrohet gjilpëra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 3.7                                                                                                                                                           | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.                                                                                                                                                           |
| 3.8                                                                                                                                                           | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 3.9                                                                                                                                                           | Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin, nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjithës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                      |
| 3.10                                                                                                                                                          | Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 3.11                                                                                                                                                          | Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.                                                                                                                                                                                                          |
| 3.12                                                                                                                                                          | Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve. |
| <b>4. Armë zjarri të gjata e të shkurtra me veprim me ndërprerje (me ose pa vjaska, me mekanizëm të mbylljes së fishekut me ulje poshtë ose me rrotullim)</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 4.1                                                                                                                                                           | Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat e me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut). Për armët e zjarrit pa dhomë të përfshirë në tytë, prisni një vrimë gjatësore (gjerësia > 1/2 kalibër; gjatësia: minimumi 1/2 gjatësisë së tytës nga koni i shtytjes).                                  |
| 4.2                                                                                                                                                           | Tyta: Një prizë e shtrënguar e të paktën 2/3 e gjatësisë së dhomës duhet të ngjitet mirë në dhomë dhe duhet të vendoset sa më afër këllëfit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |

|                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 4.3                                                                           | Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 4.4                                                                           | Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| 4.5                                                                           | Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 4.1–4.4. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                             |
| 4.6                                                                           | Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjitur, që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                       |
| 4.7                                                                           | Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta, kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 4.8                                                                           | Sistemi automatik: Përpunoni një kon prej minimumi 60 gradë (këndi i majës), në mënyrë që të merrni një diametër bazë të barabartë me të paktën 10 mm ose diametrin e faqes së këllëfit.                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 4.9                                                                           | Sistemi automatik: Hiqni kunjin e shkrepjes, zmadhoni vrimën e kunjit të shkrepjes në një diametër minimal prej 5 mm dhe bashkoni vrimën e kunjit të shkrepjes.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 4.10                                                                          | Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.                                                                                                                                                                                                           |
| 4.11                                                                          | Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve. |
| <b>5. Armë zjarri të gjata me përsëritje (me rimbushje, me ose pa vjaska)</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 5.1                                                                           | Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut). Për armët e zjarrit pa dhomë të përfshirë në tytë, prisni një vrimë gjatësore (gjerësia > 1/2 kalibër; gjatësia: minimumi 1/2 gjatësisë së tytës nga koni i shtytjes).                                    |
| 5.2                                                                           | Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.                                                               |
| 5.3                                                                           | Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 5.4                                                                           | Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 5.2 mund të përdoret për këtë qëllim.                                                                                                                                                                                                                   |
| 5.5                                                                           | Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 5.1–5.4. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                             |
| 5.6                                                                           | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtrohet gjilpëra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 5.7                                                                           | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.                                                                                                                                                                     |
| 5.8                                                                           | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 5.9                                                                           | Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjitur që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                        |
| 5.10                                                                          | Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta, kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 5.11                                                                          | Magazina/krehri: Saldohet magazina/krehri me pika saldimi me dorezën e armës ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, për të parandaluar heqjen e magazinës nga arma.                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 5.12                                                                          | Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri mungon, vendosen pika saldimi ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, ose fiksohet një kyç, për të parandaluar futjen e magazinës në armë.                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 5.13                                                                          | Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri është në formë tubi, kalohet një ose disa shufra, që lidhin në mënyrë të përhershme dhomën me kornizën dhe sigurohen me saldim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 5.14                                                                          | Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta, duke përdorur                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |

|                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                   | shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 5.15                                                              | Zhurmëzbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë së gazeve. |
| <b>6. Armë zjarri të gjata gjysmautematike (me ose pa vjaska)</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 6.1                                                               | Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë, duke përfshirë folenë e fishekut, kur është e pranishme (gjerësia: $> 1/2$ kalibër; gjatësia: për tytat me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut). Për armët e zjarrit pa dhomë të përfshirë në tytë, prisni një vrimë gjatësore (gjerësia $> 1/2$ kalibër; gjatësia: minimumi $1/2$ gjatësisë së tytës nga koni i shtytjes).                           |
| 6.2                                                               | Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri $> 50\%$ e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.                                                           |
| 6.3                                                               | Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 6.4                                                               | Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 6.2 mund të përdoret për këtë qëllim.                                                                                                                                                                                                                 |
| 6.5                                                               | Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 6.1–6.4 dhe 6.12. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri, duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                  |
| 6.6                                                               | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 6.7                                                               | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet me makinë metalprerëse ose hiqet faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.                                                                                                                                                          |
| 6.8                                                               | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 6.9                                                               | Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjithës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                      |
| 6.10                                                              | Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta, kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 6.11                                                              | Sistemi automatik: Shkatërrohet pistonin i gazit, tubi i gazit dhe rruga e gazit, duke i prerë ose salduar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| 6.12                                                              | Sistemi automatik: Nëse nuk ka pistonin e gazit, hiqet tubi i gazit. Nëse tyta përdoret si piston gazit, saldohet tyta e çaktivizuar me trupin e armës. Në të gjitha rastet kur është e pranishme, mbyllet rruga e daljes së gazit nga tyta me saldim.                                                                                                                                                                                                                             |
| 6.13                                                              | Sistemi automatik: Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme e pistonit të gazit në një kënd 45 deri në 75 gradë në raport me origjinalin. Materiali duhet të hiqet në të gjithë sipërfaqen e pistonit në mënyrë që të reduktohet në minimumin prej 50% të masës origjinale. Fiksohet pistonin në mënyrë të përhershme me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                              |
| 6.14                                                              | Sistemi automatik: Në rastet kur pistonin i gazeve/bllokuesi i gazeve është i vendosur brenda gypit të gazeve, gypi duhet të zvogëlohet në një minimum 50%. Fiksohet pistonin në mënyrë të përhershme me mbajtësi dhe mbajtësi duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme tek arma e zjarrit, me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                       |
| 6.15                                                              | Magazina/krehri: Saldohet magazina/krehri me pika saldimi me dorezën e armës ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, për të parandaluar heqjen e magazinës nga arma.                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| 6.16                                                              | Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri mungon, vendosen pika saldimi ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë ose fiksohet një kyç, për të parandaluar futjen e magazinës në armë.                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 6.17                                                              | Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri është në formë tubi, kalohet një ose disa shufra që lidhin në mënyrë të përhershme dhomën me kornizën dhe sigurohen me saldim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 6.18                                                              | Zhurmëzbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta, duke përdorur kunj çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.                                                                                                                                                                                                           |
| 6.19                                                              | Zhurmëzbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe                                                                                                                                                  |

|                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                            | depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>7. Armë zjarri automatike (automatik të ndryshëm, mitraloza, pistoletat automatike)</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| 7.1                                                                                        | Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat e me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut).                                                                                                                                                                                                    |
| 7.2                                                                                        | Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.                                                          |
| 7.3                                                                                        | Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| 7.4                                                                                        | Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 7.2 mund të përdoret për këtë qëllim.                                                                                                                                                                                                             |
| 7.5                                                                                        | Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 7.1–7.3. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                        |
| 7.6                                                                                        | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| 7.7                                                                                        | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.                                                                                                                                                      |
| 7.8                                                                                        | Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 7.9                                                                                        | Rrëshqitësi/djepi: Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë sipërfaqen.                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 7.10                                                                                       | Rrëshqitësi/djepi (për pistoletat automatike): Hiqet susta e gjilpërës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| 7.11                                                                                       | Rrëshqitësi/djepi (për pistoletat automatike): Hiqen kanalet e mbylljes me rrëshqitje.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| 7.12                                                                                       | Rrëshqitësi/djepi (për pistoletat automatike): Kur është e zbatueshme pritët me makinë metalprerëse pjesa e brendshme e skajit të portës së nxjerrjes në një kënd 45 deri 75 gradë.                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 7.13                                                                                       | Rrëshqitësi/djepi (për pistoletat automatike): Kur bllokuesi është i heqshëm nga trupi i rrëshqitësit/djepit, bllokuesi i çaktivizuar duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme me trupin e rrëshqitësit/djepit.                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 7.14                                                                                       | Trupi dhe doreza (për pistoletat automatike): Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| 7.15                                                                                       | Trupi dhe doreza (për pistoletat automatike): Pritet me makinë metalprerëse të paktën 2/3 e pjesës fundore të shinave rrëshqitëse në të dy anët.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 7.16                                                                                       | Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjithësisht që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                              |
| 7.17                                                                                       | Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 7.18                                                                                       | Sistemi automatik: Shkatërrohet pistoni i gazit, tubi i gazit dhe rruga e gazit, duke i prerë ose salduar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 7.19                                                                                       | Sistemi automatik: Nëse nuk ka pistonin e gazit, hiqet tubi i gazit. Nëse tyta përdoret si piston gazit, tyta e çaktivizuar saldohet ose ngjitet me trupin e armës. Në të gjitha rastet kur është e pranishme, mbyllet rruga e daljes së gazit nga tyta me saldim.                                                                                                                                                                                                             |
| 7.20                                                                                       | Sistemi automatik: Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme e pistonit të gazit/bllokuesit të folesë në një kënd 45 deri në 75 gradë në raport me origjinalin. Materiali duhet të hiqet në të gjithë sipërfaqen e pistonit, në mënyrë që të reduktohet në minimumin prej 50% të masës origjinale. Fiksohet pistoni me armën e zjarrit, në mënyrë të përhershme me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. |
| 7.21                                                                                       | Sistemi automatik: Në rastet kur pistoni i gazeve/bllokuesi i gazeve është i vendosur brenda gypit të gazeve, gypit duhet të zvogëlohet në një minimum 50%. Fiksohet pistoni në mënyrë të përhershme me mbajtësi dhe mbajtësi, duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme tek arma e zjarrit, me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                   |
| 7.22                                                                                       | Magazina/krehri: Saldohet magazina/krehri me pika saldimi me dorezën e armës ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, për të parandaluar heqjen e magazinës nga arma.                                                                                                                                                                                                                                                              |
| 7.23                                                                                       | Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri mungon, vendosen pika saldimi ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë ose fiksohet një kyç, për të parandaluar futjen e magazinës në armë.                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 7.24                                                                                       | Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri është në formë tubi, kalohet një ose disa shufra që lidhin në mënyrë të përhershme dhomën me kornizën dhe sigurohen me saldim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |

|                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 7.25                                                                                               | Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 7.26                                                                                               | Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme dhe pikat e lidhjes ku është e mundur, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve.                                                                                          |
| <b>8. Armë zjarri që mbushen nga gryka, me një shkrepje (përfshijë ato me mbushje me cilindër)</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| 8.1                                                                                                | Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: $> 1/2$ kalibr; gjatësia: trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut. Për armët e zjarrit pa dhomë djegie në tytë, prisni një vrimë gjatësore (gjerësia $> 1/2$ e kalibrit; gjatësia: minimumi $1/2$ gjatësisë së tytës nga koni i shtytjes).                                                                                                                                                                                                         |
| 8.2                                                                                                | Tyta: Për armët e zjarrit me dhomë e djegie të përfshirë në tytë shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri $> 50\%$ e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë.<br>Për armët e zjarrit pa dhomë e djegie të përfshirë në tytë, duhet të futet në tytë në mënyrë të sigurt një kunj çeliku i temperuar (gjatësia: minimum dyfishi i kalibrit), në tytë nga koni i detyruar. |
| 8.3                                                                                                | Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 8.1–8.2. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri, duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 8.4                                                                                                | Në rastin e veprimit me ndërprerje: Pritet me makinë metalprerëse një kon minimumi 60 gradë, në mënyrë që të rritet kalibri me të paktën 10 mm e faqes së përparme.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| 8.5                                                                                                | Në rastin e veprimit me ndërprerje: Hiqet gjilpëra, zmadhohet vrima e daljes së gjilpërës minimumi 5 mm dhe saldohet vrima e daljes së gjilpërës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 8.6                                                                                                | Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit, midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/salidohe këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjithës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.                                                                                                                                                                       |
| 8.7                                                                                                | Mekanizmi i shkrepjes: Saldohe në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta, kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 8.8                                                                                                | Vrimat. Hiqen ose saldohe.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 8.9                                                                                                | Dhomat e ndara (të shumëfishta) të djegies (përveç cilindrit): Për armët e zjarrit me dhoma të ndara ose me shumë djegie, hiqen muret e brendshme nga dhoma/t e djegies për një minimum prej $2/3$ të gjatësisë së saj me anë të metalprerjes. Hiqen sa më shumë të jetë e mundur muret e brendshme, në mënyrë ideale të barabartë me diametrin e kalibrit.                                                                                                                                                                                                          |

## ANEKSI II

### STANDARDI I MARKIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT TË ÇAKTIVIZUARA

Të gjitha armët e çaktivizuara, në përputhje me standardet dhe teknikat e përshkruara në këtë Rregullore, duhet të markohen, sipas këtij standardi:

AA (1) bb (2) cc (3)

1. Shteti ku kryhet çaktivizimi i armëve dhe pjesëve kryesore të tyre – kodi zyrtar ndërkombëtar.

2. Simbol i strukturës/organizmit që kryen certifikimin e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre.

3. Viti i çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre.

Markimi i plotë do të vendoset vetëm në kornizën e armës së zjarrit (trupi/kutia e tytës), ndërsa shenja e çaktivizimit 2 dhe shteti i çaktivizimit 3 do të vendosen në të gjitha pjesët kryesore të tyre.

ANEKSI III  
CERTIFIKATË MODEL PËR ARMËT E ZJARRIT TË ÇAKTIVIZUARA  
(Kjo certifikatë duhet të përgatitet në letër kundër falsifikimit)

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                         |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|-----------------------------------------------------------------------------------------|
| Logo kombëtare                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |  | Emri i strukturës që verifikon dhe<br>certifikon pajtueshmërinë e çaktivizimit.<br>Logo |
| <b>CERTIFIKATA E ÇAKTIVIZIMIT</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                               |  |                                                                                         |
| <b>Numri i certifikatës:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |  |                                                                                         |
| Masat e çaktivizimit janë në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike për çaktivizimin e armëve të zjarrit, siç përcaktohet në aneksin e I, të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/337, të 5 marsit 2018.                                                                                                         |  |                                                                                         |
| <b>Emri i subjektit që ka kryer çaktivizimin:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                               |  |                                                                                         |
| <b>Shteti:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |  |                                                                                         |
| <b>Data dhe viti i certifikatës së çaktivizimit:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                            |  |                                                                                         |
| <b>Prodhuesi i armës së zjarrit të çaktivizuar:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                             |  |                                                                                         |
| <b>Tipi i armës së zjarrit:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                         |
| <b>Marka/modeli:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |  |                                                                                         |
| <b>Kalibri:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                         |
| <b>Numri serial:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |  |                                                                                         |
| <b>Shënime:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                         |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                         |
| Shenja zyrtare e Republikës së<br>Shqipërisë për çaktivizimin                                                                                                                                                                                                                                                                   |  | Emri, titulli dhe nënshkrimi i personit përgjegjës                                      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                         |
| <b>SHËNIM.</b> Kjo certifikatë përfaqëson një dokument të rëndësishëm. Kjo certifikatë duhet të mbahet në çdo kohë nga pronari i armës së çaktivizuar. Pjesët kryesore të çaktivizuara të cilave u referohet kjo certifikatë, janë të markuara me shenjat zyrtare të inspektimit, këto shenja nuk duhet të preken apo të hiqen. |  |                                                                                         |
| <b>KUJDES!</b> Falsifikimi i certifikatës së çaktivizimit konsiderohet vepër penale.                                                                                                                                                                                                                                            |  |                                                                                         |

